1011125	Zyra Arsimore Pukë	16	16
1011130	Zyra Arsimore Kavajë	31	31
1011132	Zyra Arsimore Delvinë	8	8
1011133	Zyra Arsimore Sarandë	16	16
1011159	Zyra Arsimore Kamzë, Tiranë	46	46
	TOTALI	**1,500**	**1,500**

VENDIM
Nr. 198, datë 4.3.2015

PËR PROCEDURAT E KRIJIMIT, RIORGANIZIMIT DHE MBYLLJES SË INSTITUCIONEVE PUBLIKE, OFRUESE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të neneve 23, shkronja "d", dhe 24, shkronja "a", të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

Krijimi, riorganizimi dhe mbyllja e institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale ose me urdhër të titullarit të institucionit shtetëror që ka në varësi institucionin publik ofrues, në rastin e formimit profesional.

II. Krijimi i institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional

1. Krijimi i institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, bëhet edhe me propozim të pushtetit vendor ose partnerëve socialë. Propozimi shoqërohet me një argumentim për nevojën e krijimit të këtij institucioni dhe angazhimin e përfshirjen e mundshme të partnerëve socialë.

2. Propozimi për krijimin e një institucioni publik, ofrues të arsimit profesional, paraqitet pranë ministrit përgjegjës për çështjet sociale, të paktën, një vit përpara fillimit të vitit mësimor.

3. Institucioni përgjegjës shqyrton propozimet e dërguara, sipas pikës 2 e 3, të këtij vendimi, dhe, nëpërmjet strukturave të tij, konsultohet me njësinë përkatëse vendore dhe partnerët socialë brenda një afati tremujor. Pas konsultimeve, ai vlerëson nëse krijimi i institucionit është në gjendje të përmbushë

kriteret e përgjithshme të funksionimit të institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional.

4. Institucionet publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, krijohen:

a) mbi bazën e kërkesës së tregut të punës;

b) kur ndryshojnë kushtet dhe kualifikimi për kategori të caktuara aftësish;

c) në rastin e investimeve të reja, apo teknologjive bashkëkohore, që kërkojnë aftësi të reja;

ç)në raste të tjera, në varësi të politikave të arsimit, formimit dhe punësimit.

III. Riorganizimi i institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional

1. Institucionet publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, riorganizohen:

a) për shkak të përmbushjes së disa qëllimeve ose shtimit të disa qëllimeve të tjera formuese;

b) kur lind nevoja e një bashkëpunimi më të ngushtë mes institucioneve të arsimit profesional dhe formimit profesional, për rritjen e frytshmërisë së përdorimit të infrastrukturës së tyre;

c) për të optimizuar burimet njerëzore, financiare dhe të infrastrukturës;

ç)për shkak të domosdoshmërisë së një bashkëpunimi të ri me subjekte të tjera, shtetërore apo private, nëpërmjet praktikave në ndërmarrje e institucione;

d) me kërkesë të organeve të njësive të qeverisjes vendore, mbi bazën e studimeve të argumentuara;

dh) mbi bazën e kërkesës së banorëve të zonës ku ushtrojnë veprimtarinë, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme dhe me struktura të reformuara;

e) kur vlerësohet nevoja për transferim në një zonë tjetër, për ushtrimin e veprimtarisë;

ë)në çdo rast tjetër, në kuadër të zbatimit të reformave në fushën e politikave sociale, të arsimit, formimit dhe punësimit.

2. Shqyrtimi i nevojës për riorganizim bëhet nga institucioni përgjegjës, i cili vlerëson përdorimin në mënyrë më të mirë dhe efektive të burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore.

3. Bordet dhe drejtuesit e institucioneve ofruese të arsimit dhe formimit profesional luajnë rol këshillimor në procesin e vlerësimit të nevojës për riorganizim.

IV. Mbyllja e institucioneve publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional

1. Institucionet publike, ofruese të arsimit dhe formimit profesional, mbyllen kur:

a) kanë përmbushur qëllimin për të cilin janë krijuar ose nuk e përmbushin atë;

b) nuk sigurojnë ofertë të përshtatshme për kërkesat e komuniteteve dhe tregut të punës;

c) frekuentimi nuk e justifikon mbajtjen e tyre.

2. Në çdo rast, institucioni përgjegjës bën konsultime me drejtuesit dhe bordin e institucionit, ofrues të arsimit dhe formimit profesional, njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, banorët dhe partnerët socialë.

3. Në rast se vlerësohet nevoja e mbylljes së një institucioni, ofrues të arsimit dhe formimit profesional, parashikohet një periudhë transitore, deri në 2 muaj, brenda së cilës duhet të administrohen të gjitha aspektet që preken nga mbyllja.

4. Mbyllja për institucionet publike, ofruese të arsimit profesional, fillon efektet në përfundim të vitit mësimor, ndërsa, për institucionet e formimit profesional, efektet fillojnë me mbylljen e vitit buxhetor.

5. Në urdhrin e mbylljes së institucionit publik, ofrues të arsimit dhe formimit profesional, parashikohen edhe trajtimi i punonjësve, që dalin të papunë, trajtimi i nxënësve/kursantëve, arkivimi i dokumentacionit të institucionit dhe destinacioni i mjeteve monetare e materiale, në përfundim të likuidimit përkatës.

6. Në rastin e mbylljes së një institucioni publik, ofrues të arsimit dhe formimit profesional, institucioni përgjegjës ngre një komision të posaçëm, i cili monitoron gjithë procesin e mbylljes, në përputhje me urdhrin përkatës, si dhe ankimimet që mund të mbërrijnë nga palët e interesuara.

V. Dispozita përfundimtare

1. Vendimi nr. 675, datë 25.9.2003, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të krijimit, organizimit dhe mbylljes së institucioneve të formimit profesional në varësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale", shfuqizohet.

2. Ngarkohen institucionet përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional si dhe institucionet e arsimit dhe formimit profesional për njohjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 199, datë 4.3.2015

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË, TE BASHKIA KORÇË, TË OBJEKTIT BAZA PRODHUESE E UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", PËR PËRDORIM NGA SHKOLLA E MESME BUJQËSORE "IRAKLI TEROVA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "d", të nenit 23, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", të ndryshuar dhe neneve 3/b e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga universiteti "Fan S. Noli", Korçë, te bashkia Korçë, të objektit baza prodhuese e universitetit "Fan S. Noli", Korçë, së bashku me truallin nën objekt, për përdorim nga shkolla e mesme bujqësore "Irakli Terova", sipas planimetrisë dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 235, datë 27.3.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga bashkia Korçë tek universiteti "Fan S. Noli", Korçë, të objektit baza prodhuese e shkollës së mesme bujqësore "Irakli Terova", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, universiteti "Fan S. Noli", Korçë, bashkia Korçë dhe shkolla e mesme bujqësore "Irakli Terova" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Bashkia Korçë

Fusha e përdorimit të Pronës: Arsim

Identifikoi: Enver KALINO, (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Zhani PEPO, (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Gjergj DURO, Kryetari Bashkisë (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, fax, firma, vula)

Nr. Rend.	A: Zona Kadastr.& Indeksi i Hartes	A: Nr. Pasurise	A: Lloji i Pronës	B: Emri i Pronës Adresa	B: Sip. Totale e Pronës (m²)	B: Nga Sip. Totale Sa Kuartese (m²)	C: Funksioni per te cilin perdoret Prona	C: Institucioni / Ent me pergjegjesi administrative	C: Institucioni / Ent perdorues Mbrojtja juridike i perdorimit	C: Te dhena te tjera (Shenimi te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
547	8504 Ko-L-7	4172	Truall + Ndertese	Shkolla e Mesme Agroblegtnee Rr "Abdi Qendoli"	1288	567	Arsim Pamesuniversitar	Ministria e Arsimit	Drejtoria Arsimore Shkolla Pilot	Ndertuese me 3 kate + oborr para Kend sportiv i perb.
548	8504 Ko-L-9	4173	Ndertese	Baza Prodhuese "Irakli Terova" Rr e Voskopojes	33000 m2		Arsim Pamesuniversitar			Ka ndryshime ne sip e prones
549	8501 Ko-L-10	1160	Truall + Ndertese	Shkolla "Mallkeq" Bricku i Arsimit dhe Sportit	2585	571	Arsim Pamesuniversitar			


PLAN VENDOSJE
SHKALLA 1:2500
PALA PADITËSE : Athina Xhumetiku
I PADITUR : Agjensia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë
TOKË ARË E MBIVENDOSUR ME SIP. 21850 M2 ARË
ME KUFIZIME :
VERI : Rrugë dhe truall me sip.2099.2 i paditëses
LINDJE: Kanal
JUGË : Tokë arë e bazës prodhuese
PERËNDIM : Kanal
TOKË ARË E MBIVENDOSUR ME SIP. 1700 M2 ARË
ME KUFIZIME :
VERI : Rrugë
LINDJE : Rrugë
JUGË : Tokë arë e bazës prodhuese
PERËNDIM : Kanal
ZËNË ME TOKË TË NDARË NË PRONËSI 250 M2
ZËNË NGA KANAL 300 M2
ZËNË NGA KANAL 900 M2
97/2
2.34 Ha
a
96
1.75 ha
a
95
3.07 Ha
97/1
201
203
204
200
sip. mbivendosur
21850 m2
300 m2
Kanal
a
94
3.58 Ha
a
93
1.87 Ha
Lumi
Korcë ,më 23.07.2010


HARTË ME INDEKS K-34-126-61
Korçë
P
L
J
VIJA KUFIZUESE E BAZËS PRODHUESE T
SHKOLLËS SË MESME BUJQËSORE " IRA
TËROVA " ME SIPËRFAQE 33.25 Ha ARË
a
102
7.64 Ha
206
205
101
1.06 Ha
VIJA E VERDHË E QYTETIT KORÇË
212
T.R.
100/2
a
100/1
0.30 ha
2.18 Ha
PUNOI
EKSPERTI
Top. Robert PAPI
Nr. Lic. TZ 0423
a
99
2.15 ha
a
102/2
1.85 ha
Drenicës

VENDIM
Nr. 200, datë 4.3.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, TË OBJEKTIT ME EMËRTIMIN "ISH-DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT, KORÇË", PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 906, DATË 19.12.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pasuritë e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, të objektit me emërtimin "Ish-Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë", sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për t'u përdorur për mjedise pune, për krijimin e kushteve për zhvillimin normal të veprimtarisë administrative të këtij institucioni.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Arkivi Shtetëror Vendor, Korçë, nuk mund t'a ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t'a tjetërsojë atë apo t'ua japin në përdorim të tretëve.

3. Prona, e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të miratuar me vendimin nr. 906, datë 19.12.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe t'i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të miratuara me vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUEJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror: **Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Shërbimi Kombëtar i Punësimit**

Bashkia: **Korçe**

Fusha e perdorimit te prones: **Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korcë dhe Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Korce**

Identifikoi: Ilir KARANXHA, Specialist për Investimet (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Brikena NALLBANI, Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Genci KOJDHELI, Drejtor i Përgjithshëm Tel:35544538800 (emri,mbiemri, pozicioni zyrtar, tel.firma,vula)

Nr rend	A			B			C			
	Zona Kadastrale dhe Indeksi i Hartes	Nr Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Siperfaqja Totale e Prones (m2)	Nga Sip.Totale sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			Administrative	Zyre Rajonale e Punesimit Korçe Lagjia nr.9 Rruga"1 Maji" Korçe	467.9	400	Zyre Rajonale Punesimi	M.P.Ç.S.SH.B	SH.K.P/ ZRP Korçe (ne pronesi)	Ambientet ndodhen ne nje ndertese 3 kateshe ne pronesi te MPÇS e rikonstruktuar me fondet e B.Boterore per Zyre Punesimi. Z.R.P e zhvillon aktivitetin ne katin e dyte dhe QFP ne katin e trete te nderteses.Katin e pare te saj e ka ne perdorim Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore.

VENDIM
Nr. 201, datë 4.3.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TE MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË, PËR QENDRËN RINORE KORÇË, TË KATIT TË PARË TË OBJEKTIT, ME EMËRTIM "ISH-SHTËPIA E USHTARAKËVE", KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2002, "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për Qendrën Rinore Korçë, të katit të parë të objektit, me emërtim "Ish-Shtëpia e Ushtarakëve", Korçë, për ta përdorur për mjedise pune për krijimin e kushteve për zhvillimin normal të veprimtarisë së funksionimit të këtij institucioni.

2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Qendra Rinore Korçë nuk mund ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë apo t'ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama





UDHËZIM
Nr. 7, datë 25.2.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 10.3.2014 "PËR PLANIFIKIMIN E FONDEVE TË PAGESAVE PËR AFTËSINË E KUFIZUAR"

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar", të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 160/2014 , datë 27.11.2014 "Për buxhetin e vitit 2015", pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar, të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të ndryshuar dhe pikës 11 të vendimit nr. 404, datë 20.6.2012 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës, të kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit, dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse", të vendimit nr 8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga heqja e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike", udhëzimit nr 2, datë 6.2.2012, të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe udhëzimit plotësues nr. 2, datë 9.1.2015 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit 2015",

UDHËZOJ:

1. Në pikën 3, paragrafi i dytë riformulohet me këtë përmbajtje:

"Për të gjitha kategoritë mbahen parasysh pagesat e diferencuara që përfitojnë individë të veçantë për periudhën kur ndjekin arsimin e mesëm, të lartë apo pasuniversitar, pagesave për kompensimin financiar për energjinë elektrike,

telefoninë fikse, pagesave për kompensimin për heqjen e fashës deri në 300 kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike, pagesën për paketën higjieno-sanitare.

Të dhënat e mësipërme plotësohen sipas mod. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi".

2. Në pikën 10, shprehja "sipas pikës 8", zëvendësohet me shprehjen "sipas pikës 9".

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

Moduli 1

QARKU_____
BASHKIA, KOMUNA_____

Programimi i fondeve për pagesat e aftësisë së kufizuar Datë, më_____

Nr	Emërtimi	Numri i personave PAK	Masa e pagesës	Fondi vjetor
I	**Personat me aftësi të kufizuar gjithsej (a+b+c) + kujdestar**			
1	**Me aftësi të kufizuar mendore, fizike gjithsej (a+b+c)**			
a	100%			
b	200%			
c	300%			
d	**Kujdestarë gjithsej**			
	100%			
	150%			
II	**Të verbër gjithsej (a+b+c+d)+ kujdestar**			
2	**Të verbër gjithsej (a+b+c+d)**			
a	100%			
b	150%			
c	200%			
d	300%			
	Numri kujdestarëve			
	Kompensim energjie verbër me kujdestar			
	Kompensim energjie verbër pa kujdestar			
	Kompensim telefoni për të verbër gjithsej			
	Kompensim për heqjen e fashës deri 300kwh			
III	**Para e tetraplegjik+kujdestar+pakete H.S**			
3	**Para e tetraplegjik, gjithsej**			
a	100%			
b	200%			
c	300%			
d	**Kujdestarë gjithsej**			
	100%			
	150%			
e	**Paketa hijeno-sanitare**			
	Kompensim energjie para e tetraplegjik me kujdestar			
	Kompensim energjie para e tetraplegjik pa kujdestar			
	Kompensim telefoni për para e tetraplegjik gjithsej			
	Kompensim për heqjen e fashës deri në 300kwh			
IV	**Nr. i invalidëve gjithsej (a+b+c+d)**			
a	Sëmundje e përgjithshme, grupi I			
b	Sëmundje e përgjithshme, grupi I I			
c	Sëmundje profesionale, grupi I.			
d	Sëmundje profesionale, grupi II			
	Totali i PAK			

ADMINISTRATORI **KRYETARI**

UDHËZIM
Nr. 8, datë 25.2.2015

PËR PLANIFIKIMIN E FONDEVE PËR NDIHMËN EKONOMIKE

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 35, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe në zbatim të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 6.2.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si edhe udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2 datë 9.1.2015, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015",

UDHËZOJ:

1. Administratori shoqëror në bashki/komunë, në përputhje me kriteret dhe treguesit, programon kërkesat për fonde për ndihmën ekonomike dhe i dërgon në zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

2. Programimi i fondeve për ndihmën ekonomike:

Programimi i fondeve mbështetet në numrin e popullsisë gjithsej, numrin e familjeve, vlerësimin e varfërisë dhe numrin e familjeve në NE, strukturën e anëtarëve të familjes (bashkëshortët, bashkëshort i vetëm, anëtarët mbi moshë pune, në moshë pune, dhe nën moshë pune); personat që kanë statusin e jetimit; numrin e familjeve që kanë fëmijë të lindur njëherësh, si: trinjakë, katërnjakë apo pesënjakë, viktima të trafikimit, viktima të dhunës në familje, fëmijë në familje kujdestare, fëmijë që ndjekin arsimin e detyrueshëm, numri i vaksinave për fëmijët e vaksinuar të familjeve në NE, etj.

Në bazë të dokumentacionit, vlerësohen edhe të ardhurat që llogariten sipas koeficienteve nga pasuria, toka, blegtoria, duke përjashtuar qarqet Tiranë, Elbasan dhe Durrës.

3. Fondet e nevojshme për ndihmën ekonomike për bashkinë/komunën përllogariten në bazë të treguesve të mësipërm sipas mod. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Njësitë vendore, kërkesat për fondet i programojnë sipas mod. 1 dhe i dorëzojnë në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, në fund të muajit qershor të vitit në vazhdim.

5. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror vlerësojnë kërkesat në përputhje me kriteret në fuqi dhe hartojnë nevojat për fondet e blloknd ihmës ekonomike në nivel qarku dhe së bashku me mod. 1 për secilën bashki/komunë, brenda datës 10 korrik i dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror vlerëson kërkesat e ardhura nga rajonet dhe programon fondet për projketbuxhetin e vitit pasardhës në nivel kombëtar, të cilat i përcjell në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

7. Në fund të muajit nëntor të vitit në vazhdim bashkitë/komunat përditësojnë kërkesat për fonde sipas mod. 1 dhe i paraqesin në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

8. Drejtoritë rajonale këto kërkesa i përcjellin brenda datës 10 dhjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

9. Shërbimi Social Shtetëror bën detajimin e fondeve të programuara për blloknd ihmën sipas ligjit të buxhetit të vitit pasardhës për çdo bashki/komunë dhe i përcjell në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

10. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë bën transferimin e fondeve si grante të kushtëzuara për dymujorin e parë sipas pikës 9 të këtij udhëzimi dhe për vazhdimësinë transferta do të bëhet për çdo dymujor.

11. Drejtoria Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dërgon brenda datës 10 të muajit shkurt, prill, qershor, gusht dhe tetor, në Drejtorinë e Financave të MMRS, sektori i buxhetit, treguesit statistikorë mbi numrin e familjeve, individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe fondin faktik të shpenzuar të çdo 2-mujori, për çdo bashki/komunë, fond ky i cili do të shërbejë për çelje në 2-mujorët pasardhës, konkretisht treguesit statistikorë dhe fondi i shpenzuar të muajit nëntor-dhjetor, do të shërbejë për çeljen e fondeve për periudhën mars-prill, e kështu në vazhdimësi për dymujorët e tjerë.

12. Udhëzimi nr. 4, datë 11.3.2014 i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë "Për planifikimin e fondeve për ndihmën ekonomike" shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

Moduli 1

QARKU_____
BASHKIA, KOMUNA_____

Programimi i fondeve, për shpërndarjen e ndihmës ekonomike

Nr	Emërtimi	Struktura në numër	Masa e pagesës	Fondi mujore lekë
1	Popullsia gjithsej			
2	Familje gjithsej			
3	% e familjeve në skemë			
-	Familje në skemë, e ndarë kjo			
4	Bashkëshortët			
5	Bashkëshort i vetëm			
6	Anëtarë mbi moshë pune			
7	Anëtarë në moshë pune			
8	Anëtarë nën moshë pune			
9	Jetim 18-25 vjeç			
10	Jetim mbi 25 vjeç			
11	Numri i fëmijëve 3-njakë të familjeve			
12	Numri i fëmijëve 4-njakë të familjeve			
13	Numri i fëmijëve 5-njakë të familjeve			
14	Viktima të dhunës			
15	Viktima të trafikimit			
16	Kompensim energjie për familjet në skemë.			
17	Kompensim energjie për heqjen e fashës deri 300kwh për familjet në NE			
18	Kompensim energjie për personat me PAK			
19	Kompensim energjie për heqjen e fashës deri në 300kwh për personat me PAK			
20	Fëmijë deri në moshën 16 vjeç që ndjekin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar (janar-qershor; shtator-dhjetor)			
21	Numri i vaksinave për fëmijët në familjet përfituese të NE			
22	Fëmijë në familje kujdestare			
23	Fëmijë me AK në familje kujdestare			
24	Nr. i fëmijëve në familje kujdestare që përfitojnë shpenzime veshje + indirekte			
25	Nr. i fëmijëve në familje kujdestare që përfitojnë shpenzime shkolle			
A	**Fondi sipas strukturës A = (4+5+6+7+8)*1 muaj**			
B	**Të ardhurat, gjithsej mujore B = (a+b+c+d) *1 muaj**			
a	Të ardhurat nga toka			
b	Të ardhurat nga blegtoria			
c	Të ardhurat nga pensionet			
d	Të ardhurat të tjera			
C	**Fondi vjetor C=(A - B) x 12 muaj)**			
Ç	Fondi për individë e kompensime {(9+10+11+12+13+14+15+16+17+18+19+22+23) x 12 muaj} + (20*10) +(21*1)+ (24*1) + (25*1)			
D	**Fondi gjithsej D= (C + Ç)**			

ADMINISTRATORI **KRYETARI**

UDHËZIM
Nr. 9, datë 25.2.2015

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 404, DATË 20.6.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË PËRFITIMIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR, NGA PERSONAT ME STATUSIN E TË VERBRIT DHE INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, PËR FATURËN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE FATURËN E TELEFONISË FIKSE"

Mbështetur në pikën 11 të vendimit nr. 404, datë 20.6.2012 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse",

UDHËZOJ:

1. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj.

2. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj.

3. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar dhe individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të cilët nuk kanë nevojë për kujdestarë, u jepet një kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 1 400 (një mijë e katërqind) lekë në muaj.

4. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj.

5. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të cilët kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj.

6. Kompensimi për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse është një pagesë mujore e cila llogaritet dhe përfitohet pranë njësisë së qeverisjes vendore ku individi i verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik, ka vendbanimin.

7. Përfituesit, objekti i këtij udhëzimi, përjashtohen nga kompensimi i çmimit të energjisë elektrike, të parashikuar në vendimin nr. 565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike", të ndryshuar.

8. Për përfitimin e kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse, individët, së bashku me deklaratën duhet të paraqesin pranë administratorëve shoqërorë në njësitë e qeverisjes vendore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kopjen e nënshkruar të kartës së identitetit;

b) Certifikatë familjare, që vërteton se individi është anëtar i familjes;

c) Kopjen e librezës së energjisë elektrike, e cila vërteton që nuk ka detyrime të prapambetura;

ç) Kopjen e librezës së telefonisë fikse, e cila vërteton që nuk ka detyrime të prapambetura;

d) Kopje të librezave të paraplegjikut dhe tetraplegjikut apo të verbërisë, të lëshuara nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të vendimit të KMCAP/KMPV.

dh) Kontratën e qirasë të lidhur sipas nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, kreu VI "Qiraja", e cila duhet të përmbajë edhe numrin e kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike dhe kontratës me entin e shërbimit të telefonisë fikse.

9. Njësitë e qeverisjes vendore shpërndajnë çdo muaj pagesat për kompensimin e faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse nga shërbimet bankare ose "Posta Shqiptare" sh.a.

10. Administratori shoqëror harton kërkesën për fonde për masën e financimit të kompensimit financiar të faturës së energjisë elektrike dhe faturës së telefonisë fikse dhe e bën pjesë të

kërkesës së planifikimit të fondeve për aftësinë e kufizuar çdo dy muaj dhe e paraqesin pranë zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

UDHËZIM
Nr. 1, datë 20.2.2015

PËR MBLEDHJEN, ADMINISTRIMIN DHE PUBLIKIMIN E REZULTATIT PARAPRAK TË ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 23, pika 1, germa "b", nenit 119, pika 2 dhe nenit 122, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat që do të zbatojnë KZAZ-ja dhe KQZ-ja për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e rezultatit paraprak te zgjedhjeve.

Neni 2
Informacioni që do të japë elektronikisht KZAZ-ja

1. Pas marrjes në dorëzim të materialit zgjedhor, KZAZ-ja duhet të dërgojë elekronikisht në KQZ informacionin për:

a) Qendrat e votimit në të cilat zgjedhjet nuk janë zhvilluar, nëse ka;

b) Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore të cilat janë vlerësuar si "Kuti të parregullta".

2. Pas plotësimit të tabelës së rezultateve të çdo QV-je, KZAZ-ja të dërgojë elekronikisht në KQZ informacionin për rezultatin e zgjedhjeve të çdo QV-je për partitë politike dhe kandidatët në mënyrën e përcaktuar në këtë udhëzim.

Neni 3
Përmbajtja e informacionit për rezultatet e zgjedhjeve

1. Informacioni për rezultatin paraprak dërgohet sipas të dhënave në tabelat e rezultateve të plotësuara nga grupet e numërimit dhe të dorëzuara në KZAZ.

2. Informacioni duhet të përmbajë domosdoshmërisht për çdo QV:

a) Numrin e zgjedhësve që kanë votuar;

b) Numrin e fletëve të votimit të papërdorura;

c) Numrin e fletëve të votimit të dëmtuara;

d) Numrin e fletëve të votimit të gjetura në kuti;

e) Numrin e votave të pavlefshme;

f) Numrin e votave të vlefshme;

g) Numrin e fletëve të votimit të hedhura gabim;

h) Shpërndarjen e votave të vlefshme sipas rastit, për partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit ose për kandidatët për kryetar bashkie.

Neni 4
Kushtet që duhet të plotësojë aplikimi kompjuterik për hedhjen, transmetimin dhe publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve

1. Aplikimi kompjuterik për hedhjen, transmetimin dhe publikimin e rezultatit paraprake duhet të njoftojë kur shkelen këto rregulla:

a) numri i zgjedhësve që kanë votuar duhet të jetë jo më i madh se numri i zgjedhësve në listën e zgjedhësve;

b) numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti duhet të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve që kanë votuar;

c) numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti duhet të jetë i barabartë me shumën e votave të pavlefshme me votat e vlefshme;

d) numri i votave të vlefshme duhet të jetë i barabartë me shumën e votave të vlefshme të shpërndara sipas rastit, për partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit ose për kandidatët për kryetar bashkie.

2. Në rast se cenohen kushtet e përmendura në pika 1 "a" dhe 1 "b" të këtij neni dhe pas verifikimeve që bën sekretari i KZAZ-së rezulton se mospërputhja vjen nga ndonjë gabim njerëzor i bërë në VNV, lejohet korrigjimi në sistem i shifrave;

3. Në rast se cenohen kushtet e përmendura në pika 1 "a" dhe 1 "b" të këtij neni dhe pas verifikimeve që bën KZAZ-ja rezulton se mospërputhja nuk vjen si pasojë e gabimeve njerëzore, por pasqyron të dhënat që janë në procesverbalin e mbylljes së votimit, aplikimi kompjuterik lejon vazhdimin e procesit duke bërë në sistem shënimin "mospërputhje".

4. Aplikimi kompjuterik nuk duhet të lejojë për asnjë arsye cenimet e rregullave të përmendura në pikat 1 "c" dhe 1 "d" të këtij neni.

Neni 5

Përgjegjësia për përcjelljen e informacionit në KQZ

Hedhja e informacionit në aplikimin kompjuterik si dhe përcjellja e informacionit të përcaktuar në këtë udhëzim, në KQZ, bëhet nën drejtimin dhe përgjegjësinë e sekretarit të KZAZ-së.

Neni 6

Mënyra e dhënies së informacionit për rezultatet nga KZAZ-ja në KQZ

1. KZAZ dërgon në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin e përcaktuar në pikën "a" dhe "b" të nenit 2 të këtij udhëzimi, menjëherë pas marrjes në dorëzim nga KZAZ-ja të kutive të fletëve të votimit dhe kutive me materialet e votimit nga të gjitha KQV-të.

2. KZAZ dërgon në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin e përcaktuar në pikën "c" të nenit 2 të këtij udhëzimi, menjëherë pas marrjes së tabelës së rezultateve nga GN-ja. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit të numërimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GN-ve sipas kësaj mënyre:

a) Sekretari i KZAZ-së, pasi GN-ja i dorëzon tabelën e rezultateve të një QV-je, ia jep atë operatorit të hedhjes së të dhënave. Operatori i hedh të dhënat e tabelës së rezultateve në aplikimin elektronik në kompjuter dhe printon në letër informacionin që ka në formë elektronike. Në momentin e printimit aplikimi elektronik automatikisht bëhet i paedituesh/i pashkrueshëm.

b) Tabela e printuar nga forma elektronike i dorëzohet GN-së nga sekretari i KZAZ-së, për të verifikuar vërtetësinë e të dhënave.

b.1) Në rast se informacioni në tabelën e rezultateve të plotësuar me shkrim dore dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të njëjta, sekretari i KZAZ-së, duke futur ne sistem kodin personal te tij, udhëzon operatorin të dërgojë në rrugë elektronike rezultatet në KQZ

b.2) Në rast se informacioni në tabelën e rezultateve të plotësuar me shkrim dore dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të ndryshme, numëruesi i parë i GN-së bën korrigjimet me shkrim dore në fletën e printuar dhe kjo fletë firmoset nga anëtarët e GN-së. Sekretari i KZAZ duke futur në sistem kodin e tij, kthen aplikimin elekronik në të editueshëm/të shkrueshëm, udhëzon operatorin të bëjë korrigjimin e të dhënave të pasakta dhe përsëritet procedura e printimit, verifikimit dhe më pas dërgimit në KQZ.

3. Pas transmetimit të të dhënave të rezultateve të QV-së në KQZ, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë tabelën e rezultateve te plotësuar e firmosur nga GN-ja dhe ta transmetojë atë në KQZ.

4. Formati i printuar dhe tabela origjinale e rezultateve plotësuar nga GN-ja i bashkëngjiten njëra-tjetrës dhe shërbejnë si dokumentacion zyrtar që i dorëzohet KQZ-së.

5. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave të të gjitha QV-ve dhe miratimit nga KZAZ-ja i tabelës përmbledhëse të rezultateve për ZAZ-në përkatëse, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike në KQZ, vendimin e KZAZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve së bashku me tabelën përmbledhëse të firmosur nga anëtarët e KZAZ-së.

Neni 7

Publikimi i informacionit lidhur me procesin e numërimit të votave

Me marrjen e informacionit nga KZAZ-të, KQZ bën publikimin në dinamikë të rezultatit paraprak në rang zone zgjedhore.

Publikimi i informacionit të mësipërm bëhet në monitorët e sallës së mediave, në faqen e KQZ-së në internet dhe printohet në letër.

Rezultatet paraprake të jepen në numër votash të vlefshme, përqindje dhe mandatet përkatëse të fituara sipas rastit, për koalicionet, partitë politike e kandidatët e propozuar nga zgjedhësit dhe kandidatët për kryetar bashkie.

Neni 8

Rezultati paraprak i publikuar nga KQZ-ja, në çdo rast, shoqërohet me numrin gjithsej të QV-ve në zonën përkatëse zgjedhore, me numrin e QV-ve mbi të cilin është llogaritur rezultati i dhënë dhe me shënimin që ky rezultat është paraprak.

Neni 9

Udhëzimi i KQZ-së nr. 17, datë 22.5.2009 "Për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit për procesin e numërimit të votave për Zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë, 2009" shfuqizohet.

Neni 10

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lefterije Luzi

VENDIM
Nr. 12, datë 25.2.2015

PËR SHFUQIZIMIN E RREGULLORES "MBI RREZIQET E TREGUT", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 72, DATË 2.6.1999, TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë rregulloren "Mbi rreziqet e tregut", miratuar me vendimin nr. 72, datë 2.6.1999, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Gent Sejko

KËRKESË

Shtetasja Feruze Dauti, e bija e Osmanit dhe e Hyses, e datëlindjes 8.12.1942, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të zhdukur të shtetasit Shpëtim Dauti dhe caktimin si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij, vëllain e tij shtetasin Dashamir Dauti.

KËRKUESE
Feruze Dauti

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 304 lekë